



Funded by
the European Union



Lufta kundër korrupsionit dhe sfidat në kuadër të integritimit evropian

Elda Zenelaj

** Elda është juriste e specializuar në shkencat e të drejtës civile. Ajo ka një ekspertizë prej 19 vitesh në çështjet e integritimit evropian në fusha të ndryshme, ku ka punuar në pozicione të ndryshme pranë ish-Ministrisë së Integritimit Evropian (2005-2015); Kryeministrisë / Departamentit për Inovacionin dhe Mirëqeverisjen (2015-2017) dhe Ministrisë së Drejtësisë (2017-2019) dhe prej shtatorit të vitit 2019 dhe aktualisht, ajo mban pozicionin e Drejtorit të Sekretariatit Teknik për mbështetjen e Këshillit Kombëtar të Integritimit Evropian, në Kuvendin e Shqipërisë.*

Nëntor 2023

Ky artikull u realizua në kuadër të projektit “Shoqëria civile kundër korrupsionit, nga një sfidë vendase në një përgjigje Evropiane!”, financuar nga Bashkimi Evropian. Përmbajtja e këtij materiali është përgjegjësi e vetme e autorit dhe në asnjë rrethanë nuk mund të konsiderohet se pasqyron qëndrimin e Bashkimit Evropian.



Lufta kundër korrupsionit konsiderohet një nga sfidat madhore të Shqipërisë në funksion të avancimit në procesin e integritetit evropian.

Sipas Raportit të Komisionit Evropian për Shqipërinë 2023 citohet se: “Shqipëria ka një nivel përgatitjeje në luftën kundër korrupsionit. Pavarësisht disa përparimeve dhe përpjekjeve të vazhdueshme në luftën kundër korrupsionit, ai mbetet një fushë me shqetësim serioz. Organet e SPAK kanë kryer hetime për një sërë çështjesh të nivelit të lartë, duke urdhëruar disa arrestime dhe dënime për një sërë çështjesh të nivelit të lartë. Në përgjithësi, korrupsioni është i përhapur në shumë fusha të jetës publike dhe të biznesit dhe masat parandaluese vazhdojnë të kenë një ndikim të kufizuar, veçanërisht në sektorët vulnerabël. Rritja e numrit të dënimeve përfundimtare në një nivel të lartë mbetet një prioritet i rëndësishëm për të trajtuar më tej kulturën e mosndëshkimit.Sektorët më të cënueshëm ndaj korrupsionit kërkojnë vlerësime të synuara të rrezikut dhe veprime të dedikara”.

Sipas Raportit të “Transparency International”, Shqipëria ka përparuar me vetëm 1 pikë, me 36 nga 35 pikë vitin e kaluar dhe se renditet në vendin e 101, nga 183 shtete të vlerësuara nga ky Raport¹.

Gjithashtu sipas rezultatit të Anketës së Barometrit Ballkanik 2023 të Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal² shqiptarët besojnë se vendi i tyre është i korruptuar më shumë se çdo kombësi tjetër në Ballkanin Perëndimor. Raporti bazohet në opinionet e 6,000 njerëzve në të gjithë rajonin dhe mbulon tema të ndryshme si politika rajonale, korrupsioni, ekonomia, siguria dhe kushtet e përgjithshme të jetesës. Ai zbuloi se 38% e shqiptarëve mendojnë se korrupsioni është një problem i madh për vendin. Kjo është shifra më e lartë krahasuar me vendet e tjera të rajonit ose 12 % më lartë se për Bosnje-Hercegovinën dhe Maqedoninë e Veriut, ku është 26%. Rreth 25% e malazezëve dhe serbëve mendonin të njëjtën gjë, me mesataren rajonale që shënonte 27%.

Aderimi i Shqipërisë në një sërë aktesh e instrumentash të ndryshëm ndërkombëtarë për luftën kundër korrupsionit si Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit (UNCAC), Konventa Penale e Këshillit të Evropës kundër Korrupsionit, Konventa Civile e Këshillit të Evropës kundër Korrupsionit ka sjellë, por edhe ka ende si detyrim, marrjen e masave në nivel ligjor e institucional në drejtim të parandalimit dhe ndëshkimit të korrupsionit.

Ndër masat më të rëndësishme të ndërmarra nga institucionet shqiptare në kuadër të luftës kundër korrupsionit përmendim: ngritjen dhe funksionimin e strukturave të specializuara hetimore dhe gjyqësore për të luftuar korrupsionin; hartimin dhe zbatimin e Strategjisë ndërsektoriale kundër korrupsionit; dixhitalizimin e 1227 e-shërbimeve on line për qytetarët; përmirësimin e transparencës së institucioneve qeveritare përmes zbatimit të ligjit për të drejtën e informimit; hartimit dhe zbatimit të planeve të integritetit në nivel qendror e vendor; ngritjes së kapaciteteve të strukturave antikorrupsion në nivel qendror siç është Drejtoria e Përgjithshme Antikorrupsion dhe krijimi i rrjetit të koordinatorëve antikorrupsion; ngritja dhe funksionimi i sistemit on line të deklarimit të të ardhurave dhe interesave për zyrtarët e lartë shqiptarë etj.

Është e rëndësishme të theksohet se pikërisht falë funksionimit të strukturave të specializuara hetimore dhe gjyqësore për të luftuar korrupsionin kemi nisur të shohim rezultate konkrete si çuarjen e zyrtarëve të lartë të korruptuar në procese gjyqësore por edhe konfiskimin e pasurive në

¹ <https://www.transparency.org/en/countries/albania>

² <https://www.rcc.int/balkanbarometer/home>

rastet e korrupsionit. Puna e SPAK është vlerësuar dhe nga *Raporti i Freedom House i vitit 2023*³ për Shqipërinë “*Nations in Transit*” i cili nënvizon se treguesi i luftës kundër korrupsionit është përmirësuar “nga 2.75 në 3.00 për shkak të një sërë akuzash të ngritura dhe vendime gjykatash të dhëna ndaj ish funksionarëve publik, si dhe rolit proaktiv të SPAK në promovimin e luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar”.

Pavarësisht arritjeve të mësipërme ka ende sfida në luftën kundër korrupsionit. Dënimi i figurave publike të nivelit të lartë ka qenë një pikë kthese në disa prej vendeve të Evropës Jug-Lindore në vitet e fundit. Dhënia fund pandëshkueshmërisë për korrupsionin dhe sidomos dënimi i fajtorëve është thelbësor në kthimin e besimit të shoqëria. Është e rëndësishme që SPAK të vijojë me ndjekjen penale të zyrtarëve të lartë që dyshohen për korrupsion duke rritur edhe hetimet pro aktive në këtë drejtim. Për të pasur sukses me përmirësimin e historikut të dënimeve dhe konfiskimeve, hetimet financiare duhet të ndiqen me prioritet të lartë në çdo rast. Fuqizimi i SPAK nëpërmjet rritjes së kapaciteteve dhe ofrimit të mbështetjes financiare të vazhdueshme për përmbushjen e detyrave ligjore, do të mundësonte që kjo strukturë të kishte një efikasitet edhe më të lartë në hetimin dhe procedimin e çështjeve komplekse të korrupsionit. E njëjta llogjikë vlen dhe për Gjykatat e specializuara në luftën kundër korrupsionit.

Gjithashtu, konsiderohet shumë i rëndësishëm, vijimi i forcimit të bashkëpunimit ndërkombëtar veçanërisht në sektorët që kanë ndikim në luftën kundër korrupsionit. Hartimi i strategjisë së re ndërsektoriale kundër korrupsionit dhe planit të saj të veprimit duhet të jetë sa më gjithëpërfshirës duke u orientuar drejt atyre fushave në të cilat ka ndikim për korrupsion si tatimet, doganat, pronat, shëndetësia, arsimi, prokurimet, etj. Mbështetja me buxhet nga institucionet e përfshira për masat që do të parashikohen në këtë strategji është jetike për të garantuar, zbatimin dhe suksesin e saj. Një tjetër rekomandim ende i pa adresuar i Komisionit Evropian prej vitesh në takimet e përbashkëta BE-Shqipëri është dhe krijimi dhe funksionimi i Zyrës së Rikuperimit të Aseteve.

Sa më transparencë të kenë institucionet në ushtrimin e detyrave të tyre aq më pak hapësira ka për korrupsion prandaj është thelbësore, rritja e transparencës së institucioneve qendrore dhe institucioneve në varësi të tyre si dhe atyre vendore dhe të pavarura përmes zbatimit të ligjit për të drejtën e informimit, ligjit të konsultimit publik, zbatimin të politikave për të dhënat e hapura, etj. Rishikimi i ligjit për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve është tashmë një kërkesë urgjente duke parë nivelin shumë të ulët të zbatimit të tij, duke ofruar më shumë mbrojtjetje dhe garanci për sinjalizuesit.

Avancimi në adresimin e çështjeve të mësipërme, jo vetëm që do të forcojë besimin e qytetarëve ndaj institucioneve por dhe do të ndihmojë Shqipërinë në përshpejtimin e avancimit të saj drejt rrugës në Bashkimin Evropian.

³ <https://freedomhouse.org/country/albania/nations-transit/2023>